

FLETË E STANDARTIZUAR E INFORMACIONIT PARAKONTRAKTOR FINANCIMI PA INTERES PËR TË PASTREHËT NGA TËRMETI

Zërat	Përshkrimi
Teksti prezantues	Ky dokument nuk përbën një ofertë ligjore detyruese. Shifrat janë dhënë në mirëbesim dhe janë një prezantim i saktë i ofertës që banka do të bëjë sipas kushteve aktuale të tregut, bazuar në informacionin e dhënë. Megjithëkëtë, këto shifra mund të luhaten sipas kushteve të tregut. Dhënia e këtij informacioni nuk përbën detyrimin e kësaj të fundit për të akorduar këtë produkt.
1. Banka	BANKA KOMBËTARE TREGTARE (BKT) SH.A Adresa: Rruga e Vilave, Lundër 1, Tiranë Adresa e web-it: www.bkt.com.al Email: info@bkt.com.al Numri i telefonit: 042 266 288
2. Qëllimi i produktit	Financimi pa interes për të pastrehët nga tërmeti ka për synim të përmbushë nevojat personale të individëve të cilët kanë mbetur pa shtëpi për shkak të tërmeteve që ndodhën në Shqipëri në datat 21 Shtator dhe 26 Nëntor 2019.
3. Përshkrimi i produktit	Financimi pa interes për të pastrehët nga tërmeti është një produkt që BKT ka për qëllim t'i ofrojë individëve të prekur nga tërmetet e ndodhura në Shqipëri në 21 Shtator dhe 26 Nëntor 2019, në formën e blerjes së një pasurie të patundshme me një çmim të dakortësuar ndërmjet palëve, qiradhënësit dhe qiramarrësit, sipas së cilës klienti është dakort të përdorë pronën në këmbim të qirasë për një afat të përcaktuar gjatë së cilës qiramarrësi do t'i paguajë qira bankës. Prona që do të jetë objekt i kontratës së qirasë do të propozohet nga vet klienti dhe më pas do të paraqitet dokumentacioni përkatës për këtë pronë pranë bankës në mënyrë që të kryhet procesi i shitblerjes. Prona objekt i kontratës së qirasë duhet të jetë e regjistruar në ASHK. Banka do të financojë deri në 100% të vlerës së kontratës së shitblerjes (100% bazuar në OMV).
4. Norma e Interesit	0%
5. Vlera e financimit	Shuma Max – 30,000 EUR
6. Monedha	EUR
7. Afati i Qirasë Financiare	Deri në 30 vjet
8. Llojet e pronave për t'u dhënë me qira	<ul style="list-style-type: none"> • Apartament
9. Parapagimi	<ul style="list-style-type: none"> • Aplikohet vetëm në rastet kur kërkohet nga qiramarrësi

<p>10. Faturimi i Pagesave të Qirasë</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Qiradhënësi do të lëshojë një faturë për të gjitha pagesat e qirasë që duhet të bëjë Qiramarrësi sipas Planit të Pagesave dhe për çdo pagesë tjetër të bërë nga Qiradhënësi, të cilat janë detyrime të Qiramarrësit. • Të gjitha pagesat e qirasë do të derdhen në llogarinë bankare të Qiradhënësit në Bankën Kombëtare Tregtare SHA • Qiramarrësi njih dhe pranon çdo faturë që lidhet me të gjitha pagesat e qirasë, do t'i komunikohen në adresën e e-mailit e deklaruar nga ai para Qiradhënësit.
<p>11. Numri dhe frekuenca e pagesave</p>	<p>Shlyerja e qirasë financiare do të kryhet me këste mujore të barabarta.</p>
<p>12. Kësti Mujor i Qirasë Financiare</p>	<p>Klienti do të paguajë këstin mujor të qirasë financiare pas 36 muajve të parë, bazuar në planin e shlyerjeve të qirasë</p>

13. Plani i shlyerjeve dhe Tabela e Llogaritjes së NEI (Normës efektive të interesit)	Termet e Qirasë Financiare dhe tabela e llogaritjes së EUR					
	Vlera e Qirasë financiare	30,000	Euro			
	Afati	360	Muaj			
	Mosha e aplikantit	30	Vjeç			
	Gjinia	Male	▼			
	Projekti	Financim pa interes për të pastrehët nga tërmeti				
	Norma e Interesit (=) 0%					
	Komisioni i Disbursimit	0.0%	-	Euro		
	Të tjerë (nëse ka)			Euro		
	Qiraja Mujore Financiare		92.59	Euro		
Norma Efektive e Interesit (EUR) 0.00%						
* -						
* Qiraja financiare do të fillojë të paguhet pas 36 muajve të parë, bazuar në planin e shlyerjeve.						
Plani i Ripagimit						
Monedha	Vlera e Qirasë Financiare	IR (in %)	Afati (në vjet)	Afati (në muaj)	Qiraja Financiare Mujore	
Euro	30,000	0.00%	30	360	92.59	
Muaji	Balanca Fillestare	Shuma e Interesit	Ripagimi i Principalit	Qiraja Financiare Mujore	Balanca në Fund	
1	30,000				30,000	
2	30,000				30,000	
3	30,000				30,000	
4	30,000				30,000	
5	30,000				30,000	
6	30,000				30,000	
7	30,000				30,000	
8	30,000				30,000	
9	30,000				30,000	
10	30,000				30,000	
11	30,000				30,000	
12	30,000				30,000	
14. Kosto shtesë të pakthyeshme në rastin kur aplikohen të tilla	Komisioni i Disbursimit		0%			
	Shpenzime noteriale dhe ligjore,		N/A			
	Vlerësimi i Pronës		N/A			
	Primi i policës së sigurimit të pronës		N/A			
15. Kosto të tjera shtesë	Të gjitha taksat dhe komisionet e lidhura me kalimin e pronësisë në emër të qiramarrësit do të mbulohen nga vet klienti (qiramarrësi).					
16. Penaliteti për shlyerje para afatit të maturimit	0%					

<p>17. Njoftimi zyrtar midis palëve</p>	<p>Të gjithë njoftimet, komunikimet midis palëve do të bëhen me shkrim dhe me pëlqimin e dy palëve të dorëzuara personalisht ose me postë të regjistruar (rekomandë) në adresën e përcaktuar në Kontratën e Kredisë ose kur është e mundur me një mjet të qëndrueshëm komunikimi (e-mail përcaktuar në Kontratën e Kredisë, disketë, CD-ROM, DVD).</p> <p>Qiramarrësi/Dorëzuesi deklaron dhe pranon që të gjithë llojet e njoftimeve të bëra në këto adresa do të konsiderohen si të marra nga ai. Klienti mund t'i paraqesë Bankës reklamimet e tij, për sa njoftohet, brenda një afati prej 15 ditësh kalendarike.</p>
<p>18. E drejta e tërheqjes nga kontrata e kredisë</p>	<p>Klienti ka të drejtë të tërhiqet nga Marrëveshja e Qirasë Financiare brenda një periudhe kalendarike 7 ditore. Në rastin kur klienti ushtron të drejtën për t'u tërhequr nga Marrëveshja e Qirasë Financiare, klienti pranon dhe merr përsipër të gjitha detyrimet si dhe shpenzime të tjera të mundshme të bankës të krijuara me palë të treta për efekt të lidhjes së kësaj Marrëveshje.</p>
<p>19. Skemat e brendshme të ankimit</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Paraqitja e kërkesës me shkrim pranë çdo dege. • Vizitë pranë çdo dege. • Nëpërmjet telefonit (+355 42 266 288) call center • Nëpërmjet adresës elektronike info@bkt.com.al
<p>20. Penalitete të tjera</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Qiradhënësi ka të drejtë të ndërpresë kontratën kur qiramarrësi nuk përdor Objektin e Qirasë sipas qëllimit të lidhjes së marrëveshjes së qirasë dhe/ose e dëmton ose e shkatërron atë, transferon të drejtat mbi Objektin e Qirasë, e jep me nën-qira ose e lë peng tek një palë e tretë pa marrë më parë pëlqimin me shkrim të Qiradhënësit, ose kur kundër Qiramarrësit ose personave të autorizuar prej tij, ekzistojnë procedura në vazhdim për shkak të të cilave rezulton se Prona është përdorur për të kryer vepra të paligjshme; • Gjithashtu qiramarrësi ka detyrimin të kryejë pagesat e here pas hershme të taksave mbi Pasurinë, shpenzimeve për energjinë elektrike, ujë, pastrim, etj., kostove, kontributeve dhe të pagesave të tjera për çfarëdo arsye, brenda një afati 90 ditor, në të kundërt qiradhënësit i lind e drejta të ndërpresë marrëdhënien kontraktuale me qiramarrësin. • Në rast se Kredimarrësi është në pamundësi për të ripaguar në kohë këstin e maturuar (kryegjënë), Banka përveç normës së interesit normal, ka të drejtë të aplikojë penaltitet në masën 1 (një)% në Euro në muaj, i llogaritur mbi detyrimin e këstit të radhës së pa paguar (kryegjë) për periudhën në të cilën ai është me vonesë në bazë të kushteve të kësaj kontrate.
<p>21. Periudha kohore e vlefshmërisë së</p>	<p>Periudha kohore e vlefshmërisë së informacionit parakontraktor është 7 (shtatë) ditë kalendarike nga data e nënshkrimit të këtij informacioni nga klienti.</p>

**informacionit
parakontraktor**

_____/_____/_____/_____
(Qyteti, dd,mm,vvvv)

Klienti: Emër Mbiemër
(Firma)

Punonjësi i Degës: Emër Mbiemër
(Firma dhe Vula e Bankës)